



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:068619

Datë: 18.12.2024

Numri i dokumentit: 06617193

C.nr.2225/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Liridona Haziri-Mustafa, me bashkëpunëtorin profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.B, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Spitali Rajonal Gjilan, me objekt kontesti kompensimi i pagesës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 12.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia e paditësit I.B, e parashtruar me datë 28.02.2024, kundër të paditurës Spitali Rajonal Gjilan, me objekt kontesti kompensimi i pagesës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri, vlera e kontestit e pa përcaktuar, **si e pa rregulluar**.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 28.02.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, për kompensimim e pagesës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri, me vlerë të kontestit të papërcaktuar.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendimin e datës 27.03.2024 i ka kthyer në plotësim padinë paditësit, duke e detyruar që të rregullojë petitumin e padisë, duke përcaktuar qartë shumën e kërkuar në emër të kompensimit dhe periudhën kohore për të cilën kërkon të kompensohet, me njoftimin e pasojave procedurale se do të konsiderohet e tërhequr padia nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor (3 ditë), ndërsa nëse i kthehet e pa plotësuar do të hedhet poshtë.

I autorizuari i paditësit, pas pranimit të këtij aktvendimi, ka dorëzuar parashtresën e datës 15.04.2024, në të cilën ka cek se *“E njoftojmë Gjykatën se lidhur me këtë çështje dhe çështje të tjera te ngjashme nuk mund të behët prezicimi dhe saktësimi i kërkesëpadisë për kompensimin e pagave shtese për ditët e punës gjatë vikendeve dhe periudhën kohore/prezencën ne pune te secilit paditës pasi qe për shkak te vlerës se madhe te kontestit e cila duhet te provohet me prova konkrete në raste të tilla kemi propozuar ekspertize financiare me qëllim te konstatimit te sakte*

te lartësisë se kërkesëpadisë dhe deri me tani praktika gjyqësore ka qene e tille sepse për llogaritjen e kësaj kërkesëpadie duhet ekspert profesional i fushës financiare/ekonomike për qaka i tejkalon njohuritë tona te profesionit te juristit/avokatit. Andaj ne në seancën përgatitorë pas pranimit te përgjigjes ne padi do te kërkojmë nga gjykata qe te caktojë ekspert financiar i cili do te marre te dhënat e nevojshme/evidencat nga e paditura qe është e nevojshme për te llogaritur periudhën kohore për te cilën kërkohen këto lloje të kompensimit, lidhur me kërkesën për kompensimin e pagave shtese për ditët e punës gjate vikendeve dhe Rrezikshmërisë. Andaj pas nxjerrjes se provës me ekspertize financiare e rezervojmë të drejtën për precizimin e sakte te kërkesëpadisë, pasi qe tani për tani është e pamundur te dihet shuma e sakte e kërkesëpadisë pa nxjerrjen e ekspertizës financiare. Nëse gjykata sipas dispozitës 151 dëshiron te nxjerre një aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, ajo duhet te shikoj nëse janë plotësuar kushtet e parapara me ligji. Kusht elementar për nxjerrjen e aktgjykimit sipas dispozitës se nenit 152 te LPK është qe pala e paditur është përgjigjur në padi. Pra, nuk mund te nxjerre aktgjykim sipas dispozitës se nenit 152 te LPK, nëse pala e paditur nuk është përgjigjur ne padi. Kusht tjetër dhe që mund të jete diskutabile, nëse gjykata mund te nxjerre aktgjykim sipas nenit 152 te LPK, kur nuk i ka pohuar faktet, por as nuk i ka mohuar ato. Duke u nisur nga interpretimi gjuhësor i dispozitës se nenit 152 te LPK, do të mund te arrihet në përfundim se gjykata mund te nxjerre aktgjykim sipas nenit 152 te LPK, vetëm nëse pala e paditur i ka pohuar faktet, e prezantuar nga ana e palës paditëse, por ne këtë rast i ka kundërshtuar ato. Kusht tjetër për nxjerrjen e aktgjykimit, ne baze te nenit 152 të LPK, është, se pala e paditur ne përgjigjen ndaj padisë i ka pohuar faktet, por e ka kundërshtuar kërkesëpadinë. Nëse pala e paditur ka pohuar edhe faktet dhe ka pohuar edhe kërkesëpadinë, atëherë gjykata ne këtë rast do te nxjerre aktgjykim ne baze te pohimit, sipas dispozitës se nenit 148 te LPK. (Në nuk kemi pranuar përgjigje në padi me të cilën e paditura i ka pohuar faktet por e paditura edhe ne përgjigjen sipas kërkesës tone ajo i ka mohuar faktet dhe kërkesat e paditësit/ses). Prandaj, nuk mund te nxjerre aktgjykim pa shqyrtim kryesor te çështjes, nëse nuk ka : Pohim te fakteve te çështjes nga ana e te paditurit derisa ne përgjigjen e kërkesës tone kemi mohim te fakteve tona e paditura sa i përket kërkesave të paditësit. Po ashtu nuk mund te nxjerre aktgjykim pa shqyrtim kryesor te çështjes, nëse kemi te bëjmë me kërkesa për te cilat palët nuk mund te disponojnë lirisht ne kuptim te nenit 3 par 3 te LPK. E kemi paguar edhe taksen e gjykatës sipas vlerës se pacaktuar, te cilën gjate procedurës pas pranimit te ekspertizës dhe precizimit te padisë do te paguajmë taksen shtesë. Ne kemi provuar ti sigurojmë provat dhe ti bashkëngjisim ne padi, por pasi ato gjenden tek e paditura, kërkojmë nga Gjykata e nderuar që të veproje sipas nenit 332 dhe 333 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ose Eksperti Financiar i siguron nga e paditura me rastin e përpilimit të ekspertizës financiare”.

Pas shqyrtimit të parashtresës, gjykata gjeti se i autorizuari i paditësit nuk ka vepruar në kuptim të aktvendimit për plotësimin e padisë, përkatësisht nuk e ka bërë plotësimin e parashtresës - padisë, sipas vërejtjeve - sugjerimeve si në aktvendimin e cekur më lartë, duke u njoftuar edhe për pasojat ligjore në rast te mos veprimit, pra parashtresa e dorëzuara nga ana e paditësit nuk e përmban kushtin e formës së shkruar si dhe çdo gjë që nevojitet që ta mundëson veprimin sipas saj.

Andaj, gjykata nga arsyet e cekura si me lartë e duke u mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 102.1 të LPK, ku parashihet se kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet në par. 2 të nenit 99, gjykata do të thërras personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë, gjykata udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet dhe e cakton një periudhë 3 ditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës, ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 102.3 të LPK-së, parashihet se do të konsiderohet e tërhequr parashtrësja, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në çoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hedhet poshtë.

Më dispozitat e nenit 142 të LPK -së, përcaktohet shprehimisht se: “Gjykata jep vendime në seancë apo jashtë seance. Vendimet e gjykatës jepen në formë të aktgjykimit apo aktvendimit. Për të gjitha çështjet tjera gjykata vendos me anë të aktvendimit”.

Gjykata me rastin e vendosjes, vlerësoj edhe parashtrësën e të autorizuarit të paditësit të quajtur plotësim i parashtrësës, mirëpo edhe me plotësimin e parashtrësës nuk është rregulluar kërkesa (petitumi) i padisë sipas udhëzimeve të gjykatës. Në këtë parashtrësë me të cilën pretendohet se është bërë precizimi i kërkesëpadisë sa i përket “*kërkesave për punë gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri*”, pavarësisht kësaj nuk është precizuar kërkesa sa i përket shumës së kërkuar gjatë vikendeve dhe rrezikshmëri dhe periudha kohore se nga cila datë deri në cilën datë kërkohet kjo shumë, sepse jo domosdoshmërisht është e nevojshme marrja e provës me ekspertize financiare për të përcaktuar vlerën e kontestit, rrjedhimisht e paditura duhet të ketë para vetes një kërkesë të qartë në mënyrë që të deklarohet për të, andaj nën këto rrethana sipas vlerësimit të gjykatës kjo çështje nuk mund të procedohet tutje.

Bazuar në këtë dhe në mbështetje të dispozitave nga neni 99, 102, 390 e lidhur me nenin 387, e lidhur me nenin 142 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2225/24, datë 12.12.2024

Gjyqtarja,
Liridona Haziri-Mustafa

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.